



Protokoll i Përbashkët Referues Për Institucionet e Drejtësisë për Fëmijë

Prishtinë, 2012

Botuar nga:

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK)

Protokolli është përgatitur nga:

Agim Maliqi, Gjyqtar në Gjykatën Komunale në Ferizaj;

Isuf Sadiku, Prokuror Komunal në Gjilan;

Burim Çerkini, Prokuror Komunal në Ferizaj;

Fatime Ismajli, Udhëheqëse e Komisionit të Ndërmjetësimit;

Armen Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Masa dhe Dënime Alternative, Shërbimi Sprovues i Kosovës;

Bajram Kelmendi, Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Sociale, MPMS;

Fahredin Vërbovci, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë, Policia e Kosovës; dhe

Yll Zekaj, Drejtor Ekzekutiv në Odën e Avokatëve të Kosovës;

Kontribues:

Në emër të UNICEF-it:

Ardian Klaiqi, Zyrtar për Mbrojtjen e Fëmijëve në UNICEF

Shaban Murturi, Bashkëpunor i Projektit në UNICEF

Në emër të IGjK-së:

Besim Morina, Udhëheqës i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor në IGjK

Valon Jupa, Këshilltar Vendor në IGjK

Të drejtat e autorit © 2012 Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGjK)

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij protokoll është vetëm përgjegjësi e IGJK-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGjK).

HYRJJE

Mirëqenia dhe mbrojtja e fëmijëve kërkon që sistemi i drejtësisë për të mitur të ketë një bashkëpunim dhe koordinim shumë të ngushtë me qëllim arritjen e synimeve për parandalimin dhe luftimin e akteve të kundërligjshme të kryera nga të miturit, mbrojtjen e tyre, risocializimin dhe re-integrimin e shëndoshë në familje dhe shoqëri.

Konkretizimi i një bashkëpunimi dhe koordinimi të tillë, përveç bazës ligjore dhe strukturave institucionale ekzistuese, mundësohet dhe lehtësohet përmes, zhvillimit të Protokolleve referuese, me anë të të cilave do të ngrihej në nivel më të lartë ky bashkëpunim dhe krijohet qëndrueshmëria e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë për të mitur si: Gjykatave, Prokurorive, Policisë së Kosovës, Shërbimit Sprovues, Ndërmjetësimit, Qendrave për Punë Sociale, Avokatëve, Qendrave Korrektuese etj, të cilat janë të ndërlidhura me aktivitetet e përditshme në fushën e drejtësisë për të mitur në përputhje me kompetencat e tyre të përcaktuara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, si dhe në aktet e tjera ligjore.

Përmes Protokollit të përbashkët referues, synohet që të rritet dhe forcohet bashkëpunimi ndërmjet këtyre institucioneve me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të të miturve, duke u kujdesur dhe siguruar zbatimin sa më efektiv të ligjeve të aplikueshme nga fusha e drejtësisë për të mitur.

Protokolli synon që të detajizoj dhe mundësoj forcimin e këtij bashkëpunimi dhe në mënyrë të veçantë përshkruan dhe udhëzon institucionet dhe bartësit e përgjegjësive që bashkëpunimi dhe koordinimi të jetë primar në punën e tyre.

Protokolli do të shërbejë edhe si lehtësues në bashkërendimin e aktiviteteve të institucioneve kryesore të drejtësisë për të mitur, në mënyrë që gjatë punës së tyre të arrihet interesi më i mirë i të miturit të garantuar me ligjet vendore dhe aktet ndërkombëtare.

Parimet:

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit të veprës penale.

Parimet e Drejtësisë për të Mitur janë:

- ✚ Parimi i urgjencës së procedurës penale ndaj të miturit;
- ✚ Parimi i konfidencialitetit të procedurës ndaj të miturit;
- ✚ Parimi i mosgjykimit në mungesë i të miturit;
- ✚ Parimi i oportunitetit;
- ✚ Mirëqenia e të miturit; dhe
- ✚ Interesi më i mirë i të miturit.

ROLI DHE PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE KYÇE

1. POLICIA

1.1 Roli:

Detyrë parësore e policisë është që të hetoj veprat penale të kryera dhe të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar vendndodhjen e kryerësit, të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja, të gjejë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale. Policia ka të drejtë të ndalojë të marrë edhe informacione shtesë nga personat e tjerë që gjenden në vendin e ngjarjes e të cilët mund të japin informacion të rëndësishëm si për kryesin e veprës penale ashtu edhe për rrjedhjen e ngjarjes në përgjithësi.

Duke marrë parasysh se procedura penale ndaj kryesve të mitur është specifike edhe detyrat e policisë ndaj personave të mitur janë më specifike. Siç dihet në procedurën penale për të mitur përfshihen institucione të specializuara në fushën e drejtësisë për të mitur, siç është organi i kujdestarisë, ku është detyrë e policisë që në rastet kur kemi të bëjmë me të dyshuar të mitur, menjëherë të njoftohet organi i kujdestarisë. Përveç organit të kujdestarisë duhet që për çdo fazë të procedurës kur është i përfshirë i mituri të jenë të njoftuar familja e tij gjegjësisht prindërit e të miturit si përfaqësues ligjorë të tij duhet që gjithnjë të marrin pjesë në çdo fazë të procedurës e cila zhvillohet ndaj fëmijës së tyre.

1.2 Dispozitat e shërbimeve:

1.2.1 Veprimet e ndërmarra nga zyrtari policor

Veprimet e ndërmarra nga Zyrtari Policor nga momenti i dyshimit të veprës penale e deri në dorëzim në prokurori. Për tërë këtë proces është duke u bërë edhe Procedura Standarde e Operimit¹ (PSO) për zyrtarët policor.

1.2.2 Faza e parë e veprimit

Kur ka dyshime se i mituri është kryes i veprës penale, zyrtari policor i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme² sipas ligjit në fuqi si dhe PSO-së, ashtu që të miturin e sjell në stacion

¹ PSO-ja është një grup i eprorëve të Policisë së Kosovës që janë duke hartuar procedurën dhe në momentin e finalizimit do të informoheni me kohë.

² **Shpjegim se çka janë veprimet e nevojshme:** Në të pranuar informatën se fëmija është viktimë, zyrtari policor menjëherë fillon me grumbullimin dhe regjistrimin e të gjitha informatave të mundshme duke filluar nga koha e ndodhjes së VP, pastaj vendin e incidentit, natyrën e lëndimit, të dhënat e fëmijës- viktimë, të dhënat e mundshme për të dyshimtin (përshkrim i shkurtë), të gjitha informatat lidhur me përdorimin e mjeteve nga i dyshuari, gjendjen e të dyshimit në momentin e kryerjes së VP (nën ndikim të alkoolit apo ndonjë gjëje tjetër); afërsinë familjare në mes të dyshimit dhe viktimës me fjalë tjera çdo informatë që mundë të jetë relevante për rastin në fjalë, informimi i akterëve tjerë (njësia për mbrojtjen e viktimave, prokurorin kompetent, punëtorin e

policor për intervistim në dhomën shoqërore. Në asnjë moment, zyrtari policor nuk ka të drejtë që të filloj procedurën intervistuese në dhomën shoqërore pa qenë prezent kujdestari/punëtori i Qendrës për Punë Sociale si dhe në disa raste edhe psikologu (në rast se fëmija është me aftësi të kufizuara dhe i traumatizuar), si dhe në raste tjera specifike edhe interpretuesi i gjuhës për komunitetin me aftësi të kufizuara.

1.2.3 Faza e dytë e veprimit

Gjatë procesit intervistues të të miturit, zyrtari policor duhet të silllet në mënyre sa më profesionale dhe të urtë³ dhe në raporte shoqërore me të miturin. Intervistimi i të miturit mund të bëhet maksimalisht dy here, në rastet kur i mituri është në cilësinë e të dëmtuarit apo dëshmitarit⁴. Me vendim të prokurorit, 24 orë policia ka të drejtë që ta mbaj në “qendër për mbajtje” të miturin edhe atë në dhomë të ndarë nga të rriturit (sipas standardeve më të larta). Sikurse te procedura ndaj të rriturve, para çdo marrje në pyetje të të miturit duhet të informohet për:

- veprën penale për të cilën akuzohet;
- Të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje, përveç informacionit mbi identitetin e tij;
- Të drejtën në përkthim falas;
- Të drejtën për ndihmën e mbrojtësit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje;
- Faktin se deklarimi i tij mund të përdoret si provë para gjykatës;
- Faktin se ai mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij;
- Obligimin se duhet ta njoftoni këtë institucion për çdo ndryshim të adresës apo për qëllimin e ndërrimit të adresës. Më pas fillon marrja e deklaratës dhe pas përfundimit të miturit duhet lexuar me zë dhe që në fund duhet ta nënshkruajnë të gjithë të pranishmit, i mituri, mbrojtësi/avokati, prindi, personi që e ka marr në pyetje – zyrtari policor.

QPS si dhe akterët tjerë varësisht nga lloji i incidentit; vrasje, trafikim me qenie njerëzore, prostitucion, dhunim).

³ **Mënyra profesionale dhe e urtë:** Gjatë procesit të intervistimit, zyrtari policor duhet që të përkujdesët që ne dhomën e intervistimit për të mitur të mos ketë prezent shumë persona duke i kushtuar rëndësi hezitimit të dhënies se përgjigjes se fëmijës në prezencë të prindërve, te mos ngutet me pyetje dhe me pas ne marrjen e përgjigjeve të shpeshta, te mos premtohet në shenjën e dhuratave për fëmijën, fëmija duhet të ketë mundësinë e shprehjes së lire (me lodra, vizatime), të ndërpritet intervistimi kur polici vëren se fëmija është i lodhur, te respektohet plotësisht privatësia e tij, ne asnjë moment fëmija të mos jetë bashkë me të tjerët për çështje te sigurisë, qe zyrtari policor ne kohen e parashtrimit te pyetjeve te mos bërtas me zë por sa ma i qete, qe polici ne asnjë moment mos te bën pyetje sugjestive, etj.

⁴ Shih nenin 147 (2) i KDM-së.

1.3 Përgjegjësitë kyce:

1.3.1 Identifikimi i rrethanave kur fëmija nuk arrestohet

KDM nuk ka paraparë dispozita të veçanta lidhur me arrestimin apo ndalimin e personave të mitur, andaj aplikohen dispozitat që vlejné te madhorët.

E rëndësishme: Kohëzgjatja e arrestit apo ndalimit urdhërohet si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër, po ashtu nuk mund të kalojë 24 orë dhe pas kalimit të këtij afati ose duhet caktuar masa e paraburgimit ose i mituri duhet të lëshohet në liri. Policia e zhvillon procedurën parapenale. I mituri si personi madhor mund të ndalet për 6 orë, por për të vazhduar më pas duhet të merret udhëzimi nga prokurori se si të veprohet më tutje me të miturin. Në momentin e ndaljes së të miturit, apo para dhënies së deklaratës nga i mituri, të njëjtit duhet siguruar ndihmë ligjore të menjëhershme.⁵

1.3.2 Përpilimi i kallëzimit penal të policisë dhe dorëzimi në Prokurori

Pas mbledhjes së të gjitha provave, dëgjimit të dëshmitarëve, të dëmtuarve dhe të miturit policia përpilon kallëzim penal në të cilin do të paraqiten të gjitha provat e zbuluara në procesin e zbulimit të të dhënave për çështjen e caktuar penale. Nëse edhe pas dorëzimit të kallëzimit penal të policisë në prokurori, policia mëson fakte të reja, nxjerr prova dhe gjurmë të veprës penale, ajo detyrohet që vazhdimisht të mbledhë informata të nevojshme dhe për këtë menjëherë duhet t'ia dorëzojë prokurorit publik raportin plotësues të kallëzimit penal të policisë.

Në rastin e kundërt nëse masat dhe veprimet e kryera nga policia dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë asnjë bazë për kallëzim penal të policisë dhe nëse kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të bazuar se është kryer veprë penale, policia megjithatë i dërgon për këtë raport të veçantë prokurorit publik. Kallëzimi penal me të gjitha shkresat e tjera i dorëzohet prokurorit publik së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

⁵ KDM neni 43 paragrafi 6

2. ORGANI I KUJDESTARISË

2.1 Roli:

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (tani e tutje Ministria) është përgjegjëse për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë si dhe siguron që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim, siç është raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose diçka tjetër. Secila komunë, përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria.

Organi i kujdestarisë (OK) është organ komunal administrativ kompetent për çështje sociale përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

Secila komunë themelon një Qendër për Punë Sociale (QPS) si institucion publik që do të ketë një ose më shumë degë dhe personel të përbërë nga profesionistët me trajnime dhe kualifikime përkatëse. QPS-ja e formon OK-në dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës.

2.2 Dispozitat e shërbimeve:

Shërbimet sociale dhe familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në raste e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale.

Çdo person ose familje që e konsideron veten të jetë në nevojë sipas dispozitave të këtij ligji ka të drejtë që t'i vlerësohen rrethanat nga QPS-ja e vendit ku jeton, ose në të cilin gjendet, dhe t'i plotësohen këto nevoja nëse është e arsyeshme që qendra për punë sociale të veprojë kështu, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, përfshirë shkallën e nevojës dhe ekzistimin e burimeve për përmbushjen e saj. Kjo vlen edhe për të miturit në konflikt me ligjin.

2.3 Përgjegjësitë kyçe:

2.3.1 Të miturit në konflikt me ligjin, procedurat e punës për OK

Në procedurë ndaj të miturve, pavarësisht nga kompetencat e parashikuara qartë në dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), OK njoftohet për rrjedhën e procedurës, bën propozime dhe paraqet fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit të drejtë.

Prokurori e njofton organin kompetent të kujdestarisë me shkrim kurdo që fillon procedura kundër të miturit.

QPS-ja cakton menaxherin e rastit që ngarkohet me atë rast dhe i njëjti përgatitet për seancë gjyqësore me qëllim të mbrojtjes së interesave të të miturit.

Gjykata obligohet që për çdo vendim që merr të informon edhe OK. QPS-ja mban evidencë dhe formon dosje për të mitur.

Nëse prokurori vendos të mos fillojë procedurën përgatitore, ai e njofton OK-në.

2.3.2 Mbikëqyrja e shtuar nga OK-ja

Gjykata mund të shqipton si masë të mbikëqyrjes disa masa. Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga OK pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues apo kujdestarit dhe kur prindi, prindi adoptues apo kujdestari nuk është në gjendje të ushtrojë mbikëqyrjen e shtuar ndaj të miturit dhe kur një masë e tillë është në interesin më të mirë të miturit.

Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, i mituri mbetet me prindin, prindin adoptues apo kujdestarin. Me rastin e shqiptimit të kësaj mase, gjykata gjithashtu i cakton detyra organit të kujdestarisë, duke përfshirë:

- a) mbikëqyrjen e edukimit të miturit;
- b) lehtësimin e qasjes në aftësimin profesional dhe punësimin;
- c) sigurimin e largimit të të miturit nga çfarëdo ndikimi negativ;
- ç) lehtësimin e qasjes në kujdes të nevojshëm mjekësor;
- d) ofrimin e zgjidhjeve të mundshme për ndonjë problem që mund të shfaqet në jetën e të miturit dhe
- dh) detyra të tjera që gjykata i çmon se do të ishin në interesin më të mirë të të miturit.

2.3.3 Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga OK-ja

Organi kompetent i kujdestarisë është i autorizuar të ekzekutojë masën edukative të mbikëqyrjes së shtuar. OK menjëherë pas marrjes së aktvendimit për shqiptimin e masës edukative e cakton zyrtarin përgjegjës nga organi i kujdestarisë për ekzekutimin e masës dhe për këtë menjëherë e informon gjykatën kompetente.

OK-ja është i detyruar t'i raportoj gjykatës, e cila e ka shqiptuar masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë përkitazi me ekzekutimin e vendimit gjyqësor së paku çdo tre (3) muaj.

2.3.4 Shoqërimi i të miturit

Prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat dhe nga ata mund të kërkohej që të marrin pjesë nëse kjo është në interes të të miturit. Gjyqtari për të mitur mund ta përjashtojë prindin, prindin adoptues ose kujdestarin nga pjesëmarrja në procedurë nëse përjashtimi i tillë është në interesin më të mirë të të miturit. Kur prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit nuk e kryejnë detyrën e tyre prindërore, gjykata mund të caktojë një (1) kujdestar të përkohshëm për të miturin.

Gjykatat mbajnë evidencë të përgatitur nga QPS-ja, për punëtorët socialë, arsimtarët, pedagogët ose specialistët vullnetarë nga mesi i të cilëve caktohet kujdestari i përkohshëm. Të miturit pa përkujdesje prindërore i caktohet kujdestari nga ana e OK-së.

2.3.5 Të pranishëm në shqyrtimin gjyqësor

Përveç personave të paraparë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, përfaqësuesi i OK-së dhe përfaqësuesi i shërbimit sprovues thirren në shqyrtimin gjyqësor. Mosparaqitja e personave të tillë nuk e pengon gjykatën që ta mbajë shqyrtimin gjyqësor.

2.3.6 Njoftimi i OK-së nga ana e Gjykatës

Gjatë ekzekutimit të masës edukative, gjykata kompetente mund të shqiptojë masa adekuate për mbrojtjen e të drejtave dhe të mirëqenies së të miturit, duke përfshirë edhe vendosjen e të miturit në strehimore ose në institucionin edukativ apo të ngjashëm, vendosjen e të miturit nën mbikëqyrjen e organit të kujdestarisë ose transferimin e të miturit në ndonjë familje tjetër. Gjykata e njofton OK-në për cilëndo masë të shqiptuar.

Gjykatat, prokuroria, shkollat dhe institucionet tjera ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me OK-në në ekzekutimin e kësaj mase edukative. Prindi, prindi adoptues apo prindi birësues i të miturit e informon organin e kujdestarisë për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

OK pa vonesë e informon gjykatën kompetente për mos përmbushjen e detyrimeve të posaçme të shqiptuara në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi (KDM) nga ana e të miturit, si dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative.

2.3.7 Lirimi i të miturit

Institucioni korrektues, prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit e njofton Gjykatën dhe Shërbimin Sprovues për lirim të të miturit. Shërbimi sprovues i ofron ndihmë të miturit pas lirit për aq kohë sa ai ka nevojë, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj. Nëse është në interesin e të miturit, shërbimi sprovues mund të kërkojë ndihmë ose bashkëpunim prej OK-së ose përfaqësuesit ligjor të të miturit.

Pas lirimt të të miturit, OK ndërmerr një kujdes të veçantë për të miturin i cili nuk ka prindër apo për të miturin rrethanat familjare të të cilit nuk janë zgjidhur. Kujdesi, në veçanti përfshinë: vendosjen, ushqimin, sigurimin e veshmbathjes, trajtimin mjekësor, rregullimin e rrethanave familjare, kryerjen e aftësisit profesional dhe punësimin e të miturit.

2.3.8 Mbrojtja e fëmijëve kryerës të veprave penale, pa përgjegjësi penale

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

OK-ja ndërmerr veprimet e caktuara në pajtim me Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare për trajtimin e kryerësve të veprave penale nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet në bazë të programeve të tij. Kjo çështje më hollësisht rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

Pas njoftimit nga prokurori, për kryerjen e veprës penale nga fëmija, OK cakton menaxherin e rastit për secilin rast të referuar. Pas vlerësimit të rastit menaxheri mund të krijojë partneritet me organizatat qeveritare dhe joqeveritare (familja, shkolla, komuniteti, shëndetësia, policia, etj), me qëllim të krijimit të mundësive sa më të mira për mbrojtje dhe trajtim të fëmijës.

2.3.9 Të miturit në konflikt me ligjin si kryes të veprave kundërvajtëse

Gjykata komunale për Kundërvajtje njofton OK-në për të miturin kundërvajtës. OK bën vlerësimin e rastit dhe më pas dërgon raport me shkrim në gjykatë.

3. PROKURORIA

3.1 Roli i Prokurorit Publik në procedurën penale ndaj të miturve:

Zyra e prokurorisë publike është organ i pavarur përgjegjës për hetimin e veprave penale, për ushtrimin e ndjekjes penale ndaj personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit, për mbikëqyrjen e punës së policisë gjyqësore gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve për fillimin e procedurës penale. Në procedurën penale për të mitur, prokurori publik është i vetmi paditës për të gjitha veprat penale që kryhen nga ana e të miturve pa marrë parasysh se ato vepra penale ndiqen sipas detyrës zyrtare, sipas propozimit apo sipas padisë private.

Prokurori publik në procedurën penale ndaj të miturve mbikëqyr punën e policisë, dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme që do të shërbejnë në zbulimin e veprave penale dhe kryesve të tyre të mitur. Policia është e obliguar që gjatë procedurës penale ndaj të miturve të i përgjigjet Prokurorit publik si dhe të njoftoj atë për çdo veprim të cilin e ka ndërmarr.

Prokurori publik mbikëqyr punën e policisë edhe në procedurën parapenale. Ai mund të urdhëroj dhe të autorizoj policinë për ndërmarrjen e veprimeve hetimore në procedurën paraprake-parapenale, ende pa filluar procedura përgatitore, në rastet kur ka informacion se është kryer një vepër penale. Prokurori publik është i vetmi organ që mund urdhëroj arrestimin e një të mituri kur ka dyshim të bazuar se i njëjti ka kryer një vepër penale.

Është vendim i Prokurorit publik që një të mituri t'i caktohet masa e ndalimit policor në kohëzgjatje prej 24 orëve, nën kushtet e parapara me Kod të Procedurës Penale.

Zyrat e Prokurorisë në Kosovë janë të organizuara në nivel të: Prokurorive Komunale, nivelin e Prokurorive të Qarkut dhe Prokuroria e Shtetit.

Prokuroria Komunale ka për kompetencë lëndore që të hetoj veprat penale dhe të zbuloj kryesit e tyre, për të cilat është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në 5 vite burgim.

Prokuroria e Qarkut ka për kompetencë lëndore që të hetoj veprat penale dhe të zbuloj kryesit e tyre, për të cilat është paraparë dënimi me mbi 5 (pesë) vite burgim dhe me burgim afatgjatë.

3.2 Dispozitat e shërbimeve:

3.2.1. Procedura përgatitore

Kallëzimi penal me të gjitha provat e mbledhura nga ana e policisë, dhe me të gjitha shkresat e tjera që janë pjesë përbërëse e tij i dorëzohet prokurorit publik.

Prokurori publik pasi që ti analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese që janë pjesë e kallëzimit penal ai mund ta hedh kallëzimin penal.

Prokurori e hedh kallëzimin penal kur:

- Nuk ekziston asnjë dyshim i arsyeshëm që personi konkret ka kryer veprën penale në fjalë, përveç rastit kur ka gjasa që hetimet e mëtejshme nga policia mund të sigurojnë të dhëna të mjaftueshme, në të cilin rast prokurori vepron sipas kërkesave nga neni 209 i këtij Kodi;
- Vepra e kallëzuar nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;
- Ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;
- Vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje ose
- Ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen.

Pas pranimit të kallëzimit penal dhe pas shqyrtimit të tij, prokurori publik nëse gjen se ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale për të cilën edhe dyshohet, dhe nëse për çdo arsye nuk shqipton masën e diversitetit atëherë vendos që të filloj procedurën përgatitore ndaj të miturit.

Procedura përgatitore fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Një kopje e vulosur e aktvendimit mbi procedurën përgatitore i dërgohet pa vonesë gjyqtarit për të mitur.

Aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore duhet të përmbajë:

- Të dhëna për të miturin (emrin, mbiemrin, ditëlindjen, vendlindjen, vendbanimin, vendqëndrimin, nacionalitetin, etj) ndaj të cilit zbatohet procedura përgatitore;
- Kohën e fillimit të procedurës përgatitore;
- Përshkrimin e veprës penale (elementet);
- Emërtimin ligjor të veprës penale;
- Rrethanat dhe faktet që e arsyetojnë dyshimin e bazuar për veprën penale;
- Provat dhe informatat e mbledhura;
- Raport për ndonjë dënim apo masë të shqiptuar më parë.

Pas fillimit të procedurës përgatitore prokurori publik është i obliguar që të njoftoj organin kompetent të kujdestarisë për fillimin e procedurës përgatitore ndaj të miturit si dhe për rrjedhën e procedurës ndaj tij. Organi i kujdestarisë në çdo kohë ka të drejtë të bëjë propozime si dhe të paraqesë fakte shtesë për të miturin ndaj të cilit ka filluar procedura përgatitore në mënyrë që të arrihet deri te një vendim sa më i drejtë për të miturin.

Prokurori publik kërkon nga Shërbimi Sprovues i Kosovës që të përgatitë anketë të plotë sociale për të miturin, e cila duhet të përmbajë së paku këto të dhëna:

- të dhëna mbi moshën e të miturit dhe zhvillimin psikologjik,
- biografinë e familjes,
- biografinë dhe rrethanat nën të cilat jeton i mituri,

- nivelin shkollor,
- përvojën edukative dhe çfarëdo të dhëne tjetër relevante e cila do të shërbente për marrjen e një vendimi sa më të mirë ndaj të miturit.

Prokurori e pushon procedurën përgatitore kurdo që nga provat e mbledhura konstatohet se:

- nuk ka dyshim të bazuar se i mituri ka kryer veprën e caktuar penale;
- ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;
- vepra penale është përfshirë me falje;
- janë prezentë kushtet e parapara në nenin 56, në paragrafin 1 të KDM ose
- ekzistojnë rrethana të tjera që pengojnë ndjekjen.

Rekomandohet që, lëndët, që përfundojnë me pushim procedure në mungesë të provave apo duke u bazuar në nenin 56 të KDM, të njoftohet Shërbimi Sprovues me këto vendime.

Procedura përgatitore duhet të përfundoj brenda afatit prej gjashtë muajve nga dita e fillimit të saj. Brenda kësaj kohe prokurori publik është i obliguar që ti ndërmerret të gjitha veprimet hetimore dhe mbledhjen e të gjitha provave lidhur me veprën penale të kryer.

Çdo dëshmi, dhe çdo marrje në pyetje e të miturit për tu pranuar si provë nga Prokurori dhe për tu shërbyer para gjykatës duhet plotësuar kushtet konform Kodit të Procedurës Penale⁶ dhe Kodit të Drejtësisë për të Mitur⁷.

Nëse prokurori konsideron se nga provat e mbledhura gjatë procedurës përgatitore, gjen se ekzistojnë një nga arsyet e poshtëshënuara atëherë e pushon procedurën përgatitore⁸.

3.3 Përgjegjësitë kyce:

3.3.1 Paraburgimi ndaj të miturve

Paraburgimi i të miturit urdhërohet vetëm si masë e fundit për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Pas pranimit të kallëzimit penal apo kur një i mitur është arrestuar dhe iu ka caktuar masa e ndalimit policor prokurori publik mund të bëjë kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit.

Me rastin e paraqitjes së kërkesës për caktim të paraburgimit ndaj të miturit, kërkesa për caktimin e paraburgimit i drejtohet gjyqtarit për të mitur të gjykatës kompetente.

⁶ Kodi i Procedurës Penale, kapitulli XIX dispozitat e përgjithshme me provat

⁷ KDM, kreu IX procedura, neni 42 paragrafi 1

⁸ KDM Neni 60

Para se prokurori publik të bëjë kërkesë tek gjyqtari për të mitur për caktimin e paraburgimit duhet që i mituri t'i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm mjekësor, për tu siguruar se shëndeti i tij lejon caktimin e paraburgimit.

Në seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit duhet që të marrin pjesë prokurori publik, i mituri, përfaqësuesi ligjor i të miturit si dhe mbrojtësi i tij.

Në këtë seancë prokurori publik duhet që të arsyetoj dyshimin e bazuar se i mituri ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet si dhe arsyet e caktimit të paraburgimit si dhe arsyet pse alternativat e paraburgimit nuk do të ishin të mjaftueshme për të siguruar praninë e të miturit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës dhe për të siguruar zbatim të suksesshëm të procedurës.

3.3.2 Mosfillimi i procedurës përgatitore (Parimi i oportunitetit)

Mos fillimi i procedurës përgatitore ndaj të miturit është garanci procedurale që përcaktohet sipas KDM⁹ dhe duke marr ne konsiderate interesin më të mirë të të miturit dhe mirëqenien e tij atëherë kjo garanci procedurale duhet të zbatohet në çdo rast kur të plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në KDM. Mos fillimi i procedurës përgatitore ndaj të miturit njihet si *Parim i Oportunitetit*, i cili parim është i veçantë dhe specifik.

Sipas këtij parimi edhe pse ekziston dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale të dënueshme me më pak se tri vite burgim ose me gjobë, prokurori mund të vendos të mos e filloj procedurën përgatitore sepse mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura kundër të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin si dhe të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave tjera personale.

Rast tjetër kur prokurori vendos të mos filloj procedurën përgatitore është atëherë kur ndaj të miturit është veç duke u ekzekutuar masa edukative apo edhe dënimi për një vepër tjetër penale të kryer nga i mituri, dhe nëse duke pasur parasysh peshën e asaj vepre penale, si dhe dënimin a masën e cila është duke u ekzekutuar, zbatimi i procedurës dhe shqiptimi i dënitimit ose i masës për veprën penale nuk do t'i shërbente ndonjë qëllimi.

Për t'i vërtetuar rrethanat e lartshënuara prokurori mund të kërkojë që shërbimi sprovues ta bëjë një anketë sociale dhe kur është e nevojshme mund ta thirrë prindin, kujdestarin e të miturit, si dhe personat dhe institucionet e tjera dhe palën e dëmtuar.

Prokurori publik kur vendos të mos e fillojë procedurën përgatitore, duhet që ta njoftoj organin e kujdestarisë.

⁹ KDM neni 56 paragrafi 1 dhe 2,

3.3.3 Shqiptimi i masave të diversitetit nga ana e prokurorit publik

Sipas KDM-së, prokurori publik mund të pezulloj ndjekjen penale ndaj të miturit dhe të shqiptoj masën e diversitetit.

Masa e diversitetit mund të shqiptohet ndaj të miturit i cili ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në tri (3) vite ose për veprë penale të kryer nga pakujdesia për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë (5) vite burgim, me përjashtim të atyre të cilat sjellin si pasojë vdekjen.

Për shqiptimin e masës së diversitetit përveç kushteve formale duhet që i mituri të pranojë përgjegjësinë për veprën penale të kryer, duhet të shpreh gatishmërinë që të pajtohet më palën e dëmtuar si dhe duhet që të pranoj masën e diversitetit gjegjësisht kërkohet që të jepet pëlqimi si nga ana e të miturit ashtu edhe nga përfaqësuesi i tij ligjor për të zbatuar masën e diversitetit¹⁰.

Para vendosjes për masën e diversitetit, prokurori së pari e thërret të miturin, prindin e tij, prindërit adoptues ose kujdestarin dhe mbrojtësin.

Prokurori publik mund ti shqiptoj të miturve njëren nga masat e diversitetit të parapara në nenin 18 të KDM-së, duke u bazuar në natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe karakteristikat personale të të miturit.

Llojet e masave të diversitetit janë:

- Pajtimi në mes të kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë kërkim-faljen nga ana e miturit.
- Pajtimi në mes të miturit dhe familjes së tij;
- Kompensimi i dëmit;
- Vijimi i rregullt në shkollë;
- Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat;
- Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme;
- Edukimi në rregullat e trafikut ;
- Këshillimi psikologjik.

Pas shqiptimit të masës së diversitetit prokurori ka për obligim që të mbikëqyrë ekzekutimin e kësaj mase nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Shërbimi Sprovues përpilon raport të veçantë për ekzekutimin e masës së diversitetit ku e njofton prokurorin publik për mbarëvajtjen e ekzekutimit.

¹⁰ Neni 17 i KDM-së

3.3.4 Propozimi për shqiptimin e masës edukative apo dënimit

Pas përfundimit të procedurës përgatitore, prokurori publik mund të paraqesë propozim të arsyetuar pranë trupit gjykues për të mitur për shqiptimin e masës edukative ose dënimit.

Prokurori paraqet propozim për shqiptimin e masës edukative apo dënimit nëse nga provat e mbledhura gjatë procedurës përgatitore, vërtetohet dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale për të cilën edhe është dyshuar.

Propozimi i prokurorit duhet të përfshijë:

- Të dhënat personale të të miturit;
- Përshkrimin e veprës penale;
- Emërtimin ligjor të veprës penale me përcaktimin e dispozitave në Kodin Penal të Kosovës;
- Provat që tregojnë se i mituri e ka kryer veprën penale;
- Rezultatet e ndonjë ankete sociale të përpiluar nga shërbimi sprovues;
- Propozimin për shqiptimin e masës edukative ose dënimin ndaj të miturit;
- Arsyeja pse nuk është shqiptuar masa e diversitetit.

4. GJYKATA

4.1 Roli:

Roli i gjykatave në vendin tonë është tejet i madh. Gjykatat funksionojnë si organe të pushtetit shtetëror përkatësisht ushtrojnë pushtetin gjyqësor, kurse veprimtaria e tyre bazohet në Kushtetutë¹¹ dhe ligj¹². Me Kushtetutë janë të rregulluara parimet e përgjithshme të sistemit të drejtësisë, kurse me Ligjin mbi Gjykatat është e rregulluar fusha e organizimit, funksionimit dhe juridiksionit të gjykatave.

Sistemi i funksionimit të tanishëm të gjykatave në vendin tonë ushtrohet nga gjykatat e rregullta dhe atë: Gjykatat Komunale; Gjykatat e Qarkut , Gjykata Ekonomike e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Kodi nuk ka paraparë gjykata të veçanta apo të specializuara për trajtimin e të miturve dhe nga kjo mund të konkludoj se procedura penale ndaj të miturve zhvillohet në gjykatat e rregullta. Kurse sa i përket kompetencës reale, territoriale dhe funksionale aplikohen dispozitat e përgjithshme (Kodi i Procedurës Penale të Kosovës).

Vlen të përmendet fakti se nga 1 janari i vitit 2013, do të hyjë në fuqi Ligji mbi Gjykatat i cili do të jetë bazë për një organizim të ri të sistemit gjyqësor. Ligji parasheh që në territorin e Republikës së Kosovës të themelohen shtatë Gjykata Themelore, një Gjykatë e Apelit (me seli në Prishtinë) dhe Gjykata Supreme.

Mes tjerash Ligji, ka paraparë themelimin e Departamentit për të mitur në kuadër të gjykatave themelore dhe departament për të mitur në kuadër të gjykatës së apelit.

Gjithsesi me formimin e këtyre departamenteve do të kemi një trajtim më të veçantë dhe më gjithëpërfshirës të procedurës për persona të moshës së mitur. Me funksionalizimin e këtyre departamenteve do të arrihet profilizimi i gjyqtarëve, përkatësisht specializimi i tyre në lëmin e të miturve.

4.2 Dispozitat e shërbimeve:

4.2.1 Roli i gjykatës gjatë procedurës përgatitore

Kodi ka përcaktuar se autorizimet gjyqësore në procedurë ndaj të miturve ushtrohen përmes:

- Gjyqtarit për të mitur¹³ ; dhe
- Trupit gjykues për të mitur.¹⁴

¹¹ Kapitulli i VII i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

¹² Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e KSAK-së. Përveç Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, në Republikën e Kosovës është nxjerrë Ligji për Gjykatat (Ligji nr.03/L-199), disa nene të të cilit janë në fuqi nga 1 janari i vitit 2011, kurse si tërësi do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2013.

¹³ Gjyqtari për të mitur është gjyqtar profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjësive të parapara në këtë Kod.

Gjyqtari për të mitur gjatë procedurës përgatitore, garanton të drejtat e të miturit, ka rol mbikëqyrës së rrjedhjes së procedurës përgatitore përkatësisht ka rol ekuivalent me gjyqtarin e procedurës paraprake tek procedura e zhvilluar ndaj personave madhorë. Gjyqtari për të mitur njoftohet për zhvillimin e procedurës përgatitore ndaj të miturit përmes kopjes së vulosur të aktvendimit për fillim të procedurës përgatitore nga ana e prokurorit dhe atë pa vonesë.

E rëndësishme: Dërgimi i aktvendimit për zhvillimin e procedurës përgatitore pa vonesë nënkupton një afat abstrakt dhe do të ishte mirë që të dërgohej në ditën e marrjes së këtij aktvendimi.

Procedura përgatitore duhet të përfundoj brenda afatit prej gjashtë muajve nga dita e fillimit të saj dhe nëse procedura përgatitore nuk përfundon brenda periudhës gjashtë (6) mujore, prokurori i dorëzon gjyqtarit për të mitur kërkesë të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore dhe arsytet të cilat kanë ndikuar që kjo procedurë të mos përfundohet.

E rëndësishme: Është diskrecion i gjyqtarit për të mitur që të vazhdoj apo jo procedurën përgatitore, këtu duhet pasur parasysh gjithësi arsyeshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesës dhe gjithësi kërkesa duhet të jetë e arsyetuar edhe për faktin e mosndërmarrjes së veprimeve përgatitore gjatë periudhës fillestare.

Bazuar në logjikën e ngjarjes dhe nga fakti se gjyqtari është njoftuar për fillimin e procedurës duhet të njoftohet menjëherë për pushimin e procedurës përgatitore.

Gjyqtari po ashtu cakton ekspert të shëndetit mendor dhe mund të kërkoj nga shërbimi sprovues përgatitjen e raportit parandëshkues.

4.2.2 Roli i gjyqtarit për të mitur në caktimin e paraburgimit

Rol të rëndësishëm i gjyqtarit për të mitur është përcaktuar me rastin e paraqitjes së kërkesës së prokurorit për caktimin e paraburgimit.

Kjo fazë është tejet e rëndësishme nga fakti se paraburgimi ndaj të miturit është përcaktuar si “ultima ratio”, andaj nga kjo rrjedhimisht tek gjyqtari për të mitur rrjedhin obligime të pari në caktimin e mbrojtësit (nëse nuk është caktuar nga organet tjera paraprakisht), caktimin dhe mbajtjen e seancës dëgjimore dhe rrjedhimisht marrjen e aktvendimit për paraburgim.

E rëndësishme: Bazuar në faktin se arresti ndaj të miturit ndalimi policor maksimalisht mund të zgjatë vetëm 24 orë, ky fakt paraqet një sfidë dhe njëkohësisht nuk lejon as edhe

¹⁴ Trup gjykues për të mitur do të thotë trup gjykues - kolegji i themeluar në pajtim me Kreun X të këtij Kodi, i cili ka së paku një gjyqtar për të mitur dhe është kompetent për ushtrimin e përgjegjësisë të parapara në këtë Kod.

neglizhencën më të vogël të organeve dhe të njëjtat duhet të veprojnë me shpejtësi dhe përkushtim të lartë.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshëm mbi paraburgimin ndaj të miturve.

Që nënkupton se edhe gjatë kësaj procedure gjyqtari për të mitur në çdo kohë mund të vizitoj të paraburgosurin, të bisedoj me të dhe të pranojë ankesa¹⁵.

Vlen të përmendet fakti se i mituri nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se 12 muaj nga dita e arrestit.

4.2.3 Roli i gjyqtarit për të mitur pas pranimi të propozimit

Gjyqtari për të mitur rol tejet të rëndësishëm ka në fazën e kontrollit të propozimit (nga pranimi deri te caktimi i shqyrtimit gjyqësor) dhe pas pranimi të propozimit ka dy alternativa:

- a. Mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit; apo
- b. Transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, (nëse ekzistojnë kushtet sipas paragrafëve 1 deri në 3 të nenit 316 të KPPK-së)

E rëndësishme: Këto vendime praktikisht janë vendimet e “fundit” të cilat mund ti merr gjyqtari për të mitur, meqë të gjitha vendimet tjera i merr në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues për të mitur.

Gjyqtari për të mitur e cakton shqyrtimin gjyqësor brenda tetë ditëve nga pranimi i propozimit.

4.2.4 Roli i gjyqtarit për të mitur gjatë shqyrtimit gjyqësor

Fillimisht duhet përkujtuar faktin se me disa përjashtime dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës zbatohen përshtatshëmish në shqyrtimin gjyqësor, aktvendimin dhe aktgjykimin ndaj të miturit.

Publiku gjithmonë përjashtohet kur gjykohet i mituri.

Trupi gjykues për të mitur mund të pushojë procedurën në shqyrtimin gjyqësor dhe të shqiptojë masën e diversitetit në çdo moment nëse plotësohen kushtet nga neni 17 të KDM.

Gjyqtari për të mitur e përpilon aktvendimin ose aktgjykimin me shkrim brenda 8 ditëve nga dita e shpalljes së tij, përjashtimisht në raste të ndërlikuara afati i përcaktuar mund të zgjatet me lejen e kryetarit të gjykatës por jo më shumë se 15 ditë.

¹⁵ Neni 297 par.3 i KPPK-së

Duhet pasur parasysh se kjo mund të bëhet vetëm pas deklarimit të të miturit lidhur me fajësinë.

Trupi gjykues për të mitur është i autorizuar të marrë vendim, madje edhe nëse prokurori nuk ka ndryshuar propozimin e tij ose nëse nuk ka përgatitur propozim të ri, në bazë të provave që janë prezantuar në shqyrtimin gjyqësor, duke treguar se gjendja faktike siç është shpjeguar në propozim ka ndryshuar.

Kjo paraqet një diskrecion të trupit gjykues i cili kushtimisht mund ta “tejkaloj” propozimin e prokurorit përkatësisht nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit që është karakteristik vetëm për procedurën ndaj të miturve.

Trupi gjykues me aktvendim shqipton masat edukative kurse me aktgjykim shqipton dënimin ndaj të miturit.

Gjyqtari për të mitur e përpilon aktvendimin ose aktgjykimin me shkrim brenda 8 ditëve nga dita e shpalljes së tij, përjashtimisht në raste të ndërlikuara afati i përcaktuar mund të zgjatet me lejen e kryetarit të gjykatës por jo më shumë se 15 ditë.

4.2.5 Roli i gjyqtarit për të mitur gjatë shqiptimit të masave dhe dënimeve

Rol tejet të rëndësishëm, gjatë procedurës ndaj të miturve, gjyqtari për të mitur (tani vendimet merren si trup gjykues për të mitur) ka me rastin e vendosjes për shqiptimin e masave edukative dhe dënimin ndaj të miturit. Karakteristikë e veçantë është se në këtë procedurë me rastin e përcaktimit për masat dhe dënimet, duhet të ketë gjithmonë në fokus interesin e të miturit.

Kjo nënkupton një detyrim tejet delikatë të gjykatës dhe këtu duhet marrë parasysh të gjitha rrethanat subjektive dhe objektive e posaçërisht të ketë parasysh parimin e proporcionalitetit.

Kjo në rrafshin praktik nënkupton që me rastin e përzgjedhjes mes masave edukative dhe dënimin ti jepet prioritet masave edukative, kurse me rastin e vendosjes për llojin e masës edukative (masave disiplinore, masave të mbikëqyrjes së shtuar dhe masave institucionale) po ashtu të përcaktohet për masën më të përshtatshme me anë të së cilës do të arrihej qëllimi i masës dhe interesi i të miturit.

5. SHËRBIMI SPROVUES

5.1. Roli i Shërbimit Sprovues

Shërbimi Sprovues është institucion nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe është përgjegjës për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, si dhe për ri-integrimin e personave të dënuar në shoqëri.

SHS me punën e tij mbulon gjithë territorin e Kosovës përmes 5 (pesë) Drejtorive Regjionale (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan), ku secila prej tyre mbulon territorin që mbulon Gjykata përkatëse e Qarkut. Puna e këtyre drejtorive në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative, si dhe në ri-integrimin e personave të dënuar në shoqëri, mbikëqyret nga Drejtoria Qendrore, selia e së cilës është në Prishtinë. Me riorganizimin e Gjykatave, SHS planifikon të ketë 7 (shtatë) Drejtori Regjionale, përkatësisht në ato vende ku do të jenë selitë e Gjykatave Themelore.

5.2. Dispozitat e shërbimeve

Në procedurën ndaj të miturve, Shërbimi Sprovues në bazë të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, është i përfshirë pothuaj në të gjitha fazat e kësaj procedure. Kjo përfshirje fillon qysh kur ngritët kallëzimi penal për të miturin në prokurori, vazhdon gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor në gjykatë, pastaj me ekzekutimin e masave edukative jo institucionale dhe dënimeve alternative, si dhe me ofrimin e ndihmës post-penale përmes programit të përkujdesjes së pas lirit me qëllim të ri-integrimit të miturve në shoqëri.

Për të realizuar këtë rol, SHS duhet të bashkëpunoj me shumë institucione qeveritare ku përfshihen institucionet edukative-arsimore, Qendrat për Punë Sociale dhe Organin e Kujdestarisë, Qendrat e Aftësimin Profesional dhe ato të Punësimit, institucione shëndetësore, institucione kulturore, Policinë e Kosovës dhe institucione tjera. Përveç tyre, SHS, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase bashkëpunon edhe me organizata të ndryshme jo-qeveritare dhe komunitetin.

Në KDM, në procedurën për të mitur janë të parapara këto dispozita të shërbimeve për SHSK-në:

1. Anketa Sociale (neni 8, par. 2 i KDM);
2. Raporti Para-ndëshkues (neni 8, par.3 i KDM);
3. Roli i Zyrtarit të Shërbimit Sprovues në shqyrtimin gjyqësor (neni 70 i KDM, par.2);
4. Ekzekutimi i Masave të Diversitetit (neni 83 i KDM);
 - Pajtimi në mes kryerësit të mitur dhe palës së dëmtuar, duke përfshirë edhe kërkim faljen nga i mituri ndaj palës së dëmtuar;
 - Pajtimi ndërmjet të miturit dhe familjes së tij;

- Kompensimi i dëmit palës së dëmtuar në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë ndërmjet të dëmtuarit, të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor, në përputhje me situatën financiare të të miturit;
 - Vijimi i rregullt në shkollë;
 - Pranimi i punësimit apo aftësimit në një profesion adekuat me aftësitë dhe shkathtësitë;
 - Kryerja e punës pa pagesë në dobi të përgjithshme;
 - Edukimi në rregullat e trafikut;
 - Këshillimi psikologjik;
5. Ekzekutimi i Masave Edukative (nenet 84, par.2, 85, 86, 87, 88 të KDM);
- Ekzekutimi i masës së dërgimit në qendër disiplinore (neni 90, par. 3);
 - Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga prindi, prindi adoptues ose kujdestari (nenet 91, 92, 93 të KDM);
 - Ekzekutimi i masës për mbikëqyrje të shtuar në familjen tjetër (nenet 94, 95, 96, 97 dhe 98 të KDM);
 - Dispozitat e përgjithshme mbi masat edukative institucionale (neni 103, par.1);
 - Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin edukativ (nenet 111 dhe 112 të KDM);
 - Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm (nenet 124, 125 dhe 126 të KDM);
 - Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i masave edukative (nenet 127 dhe 128 të KDM);
6. Ekzekutimi i Urdhrit për punë në dobi të përgjithshme (nenet 132 dhe 133 të KDM);
7. Ndihma post penale - përkujdesja pas lirimit (nenet 141 dhe 142 të KDM).

Gjithashtu, Shërbimi Sprovues mbikëqyrë ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative të parapara në Kodin e Drejtësisë për të Mitur, që shqiptohen në pajtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK) dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale (LESP), siç janë:

1. Dënimi me Kusht (neni 7, par. 4 i KDM, nene 43 - 52 të KPK, si dhe nene 10 -163 të LESP-it)
2. Masat e trajtimit të detyrueshëm (neni 38, par.4, neni 144 i KDM, neni 76 dhe 77 të KPK dhe nenet 179 – 187 të LESP-it).
3. Mbikëqyrjen e personave të mitur të liruar me kusht (neni 35 i KDM, neni 80 i KPK, si dhe nenet 128 – 131 të LESP-it)

5.3. Përgjegjësitë kyce

5.3.1 Procedurat e përgjithshme të punës me raste në SHS

Me t'u pranuar rasti (kërkesa, aktvendimi, etj) në SHS, në Drejtorinë Regjionale përkatëse, së pari caktohet zyrtari sprovues përgjegjës për rastin (menaxheri i rastit), i cili është përgjegjës përcjelljen e rastit prej marrjes së kërkesës apo aktvendimit deri në përfundimin e të gjitha procedurave në lidhje me rastin. Këtu përfshihen; mbajtja e dosjes me të gjitha dokumentet për rastin, mbledhjen e informatave për rastin, mbikëqyrjen e tij, kontaktin dhe bashkëpunimin me familje, komunitetin, me shumë institucione tjera relevante me qëllim marrje dhe shkëmbimi të informatave për atë të mitur, raportimin në gjykatë apo prokurori për rastin, etj.

5.3.2 Anketa sociale dhe Raporti Para-ndëshkues

Pas pranimit të rastit, zyrtari sprovues si menaxher rasti bën vizita në teren me qëllim të mbledhjes të sa më shumë informatave relevante për realizimin e anketës sociale. Me këtë rast vizitohet familja e të miturit dhe institucione të cilat janë relevante për ofrimin e informatave (shkolla, Qendra për Punë Sociale, etj), ku intervistohet i mituri/e mitura, prindërit, si dhe ndonjë anëtar tjetër i familjes, arsimtari, punëtori social dhe ndonjë person tjetër relevant.

Pas mbledhjes së informatave të nevojshme, zyrtari sprovues shkruan raportin e Anketës Sociale / Raportin Para-ndëshkues, pas përfundimit të së cilit, ai dorëzohet në institucionin i cili edhe e ka kërkuar.

Procedurën që zhvillon zyrtari sprovues për mbledhjen e informatave, shkrimin e raporti dhe afati për përfundimin e anketës sociale/raportit para-ndëshkues duhet të kryhet brenda tri javëve prej marrjes së kërkesës.

5.3.3 Roli i Zyrtarit të Shërbimit Sprovues në shqyrtimin gjyqësor

Me ftesë të gjykatës, zyrtari sprovues (menaxheri i rastit) merr pjesë në shqyrtimin gjyqësor që mbahet për të miturin. Me këtë rast, gjatë shqyrtimit gjyqësor zyrtari sprovues prezanton pikëpamjen tij për mundësitë e risocializimit të miturit/miturës, duke ofruar dhe arsyetuar edhe ndonjë informatë që mund të jetë me rëndësi në lidhje me vendimin që merret për atë të mitur.

5.3.4 Ekzekutimi i Masave të Diversitetit

Pas marrjes së aktvendimit nga prokuroria apo gjykata për ekzekutim të masës së diversitetit përkatëse, Zyrtari Sprovues kryen këto veprime: përgatitë planin e ekzekutimit të masës që përfshin kontaktin me të miturin dhe prindërit e tij dhe palët e tjera të përfshira varësisht prej masës së diversitetit të shqiptuar (si p.sh. pala e dëmtuar, shkolla, institucioni ku mund të

kryhet puna në dobi të përgjithshme, Qendra e Aftësisimit Profesional, psikologu, autoshkollë, etj.). Pas përfundimit të ekzekutimit të masës së diversitetit, menaxheri i rastit përgatit raportin përfundimtar për prokurorinë apo gjykatën.

Në rastet kur i mituri dështon të përmbush obligimet e tij sipas aktvendimit të prokurorisë apo gjykatës, zyrtari sprovues duhet të bëjë raportin për mos ekzekutim të masës së diversitetit, në të cilin do të përshkruaj arsyet e mos ekzekutimit të saj dhe ku ka dështuar i mituri.

Kurse, në rastet ku përkundër vullnetit dhe gatishmërisë së të miturit për të kryer obligimet. Po për arsye të tjera dështon të ekzekutohet masa e caktuar e diversitetit, zyrtari sprovues bënë një raport për prokurorinë ose gjykatën, në të cilin e njofton me arsyet e moskryerjes së masës dhe të kërkoj zëvendësimin me një masë tjetër diversiteti të zbatueshme, apo edhe ta konsideroj si të përfunduar masën e shqiptuar.

5.3.5 Ekzekutimi i Masave Edukative

Në rastet kur gjykata shqipton këto masa dhe urdhëron Shërbimin Sprovues zyrtari sprovues viziton familjen e të miturit, kontakton të miturin dhe familjen e tij, shkollën, QPS, Policia, komunitet, etj. me qëllim që të përmbushen sa më mirë obligimet që dalin nga aktvendimi, si dhe të ofrimit të shërbimeve sa më efikase për të miturit.

Përmbushja e këtyre obligimeve dhe ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes do të verifikohen rregullisht nga ana e zyrtarit sprovues, i cili varësisht prej kërkesës së gjykatës është i obliguar që ta raportoj atë për progresin e arritur në ekzekutimin e kësaj mase. Edhe në rast të dështimit të përmbushjes së detyrimit të veçantë dhe vështirësive në ekzekutimin e kësaj mase, zyrtari sprovues pa vonese e informon gjykatën.

5.3.6 Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i masave edukative

Në rastet kur gjyqtari për të mitur gjatë vizitës që i bënë institucionit ku ekzekutohet masa, vëren parregullsi në trajtimin e të miturit dhe e informon Shërbimin Sprovues për një gjë të tillë, atëherë zyrtari sprovues përgjegjës, viziton institucionin korrektues (Qendrën Korrektuese) ku kontakton me përgjegjësit e institucionit, zyrtarët që janë përgjegjës për rastin dhe vetë të miturin. Në bazë të informatave që merr, zyrtari sprovues i bënë një raport gjykatës kompetente në të cilat edhe propozon masat adekuate për eliminimin e këtyre parregullsive.

Gjithashtu, Shërbimi Sprovues, përkatësisht zyrtari sprovues përgjegjës, në varësi të progresit të ekzekutimit të masës, si dhe informatave tjera mund të kërkoj nga gjykata kompetente rishqyrtimin e ekzekutimit të masës edukative.

5.3.7 Ekzekutimi i Urdhrit për punë në dobi të përgjithshme

Pas marrjes së aktvendimit nga Gjykata, Zyrtari Sprovues kontakton me të miturin dhe familjen e tij dhe institucionin ku do të kryhet puna pa pagesë.

Institucioni i zgjedhur dhe lloji i punës që duhet të kryhet nga i mituri, duhet të jetë në përputhje me aftësitë psiko-fizike të miturit. Udhëheqësi i institucionit ky do të kryhet puna cakton, një përgjegjës i cili do ta ketë nën kujdes të miturin gjatë kohës sa është ai aty, i cili së bashku me të miturin do të mbaj evidencën e orëve të mbajtura nga i mituri rregullisht. Gjithashtu, në mënyrë të rregullt zyrtari sprovues do të kontaktoj me këtë përgjegjës për rrjedhën e kryerjes së punës dhe herë pas here edhe do ta vizitoj të miturin në institucion për ta parë për së afërmi mbarëvajtjen e punës.

Gjatë ekzekutimit të UPDP-së në rast se paraqiten vështirësi në institucionin ku i mituri ka filluar të kryej orët, Zyrtari Sprovues duhet të ndërrojë institucionin ku i mituri kryen punë dhe llojin e punës. Për ekzekutim të suksesshëm, ose të pjesërishëm, si dhe në raste të mosekzekutimit të këtij urdhri, Shërbimi Sprovues i raporton me shkrim gjykatës.

5.3.8 Ndihma post penale - përkujdesja pas lirit

Gjatë kohës sa është duke u ekzekutuar masa e edukimit institucional ose burgimi për të miturin, zyrtari sprovues (menaxheri i rastit) mban kontakte me të miturin, familjen dhe institucionin ku gjendet, nëpërmjet pjesëmarrjes në “Planin për menaxhimin e rastit dhe të Përkujdesjes së pas lirit”. Ky plan realizohet në bashkëpunim me personat përgjegjës të Qendrës Korrektuese në Lipjan.

Gjatë kohës sa i mituri është në institucion, zyrtari sprovues kontakton me familjen, komunitetin dhe institucione të ndryshme, me qëllim të identifikimit të burimeve dhe mundësive të ndryshme të cilat i mituri mund ti shfrytëzonte pas daljes për risocializim dhe re integrim më të mirë në shoqëri.

Pas daljes së të miturit nga institucioni, zyrtari sprovues për një periudhë të caktuar (3-6 muaj) i ofron përkrahje duke siguruar vazhdimësi të shërbimeve dhe aktiviteteve për të miturin në komunitet, varësisht prej nevojave dhe burimeve që ka identifikuar gjatë kohës sa i mituri ka qëndruar në institucion. Për këtë qëllim, zyrtari sprovues bashkëpunon edhe me QPS, shkollën, institucione tjera dhe komunitetin.

5.3.9 Ekzekutimi i Dënimit me kusht për të mitur

Kur Gjykata shqipton dënimin me kusht ndaj një të mituri dhe urdhëron Shërbimin Sprovues për ekzekutimin e këtij dënimi, zyrtari sprovues kontakton të miturin, prindërit, shkollën, QPS dhe Organin e Kujdestarisë, institucione dhe organizata relevante që mund të lidhen me vendimin e gjykatës, me qëllim të hartimit të programit individual të mbikëqyrjes. Pas përgatitjes së programit të mbikëqyrjes, zyrtari sprovues verifikon përmbushjen ose jo të këtij

programi, obligimeve që dalin nga ai për të miturin dhe i raporton rregullisht gjykatës që e ka shqiptuar këtë dënim.

5.3.10 Ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm

Me rastin e shqiptimit të këtyre masave për të mitur nga ana e gjykatës dhe kur gjykata urdhëron Shërbimin Sprovues, të ekzekutoj këto masa, zyrtari sprovues duhet të kontaktoj me të miturin, prindërit ose kujdestarët ligjorë të tij, Organin e Kujdestarisë dhe QPS, si dhe Institucionin përkatës shëndetësor në të cilin do të realizohet kjo masë. Në bashkëpunim me këto institucione përgatit programin rehabilitues.

Zyrtari i Shërbimit Sprovues mbikëqyrë mbarëvajtjen e realizimit të programit rehabilitues dhe e informon gjykatën për përparimin e arritur në çdo dy (2) muaj.

Në rastet kur personi i mitur të cilit i është shqiptuar kjo masë, refuzon të bashkëpunoj me Shërbimin Sprovues ose për arsye të ndryshme nuk i përmbahet programit rehabilitues, zyrtari sprovues në afatin sa më të shkurtër duhet ta informoj Gjykatën.

5.3.11 Mbikëqyrja e personave të mitur të liruar me kusht

Shërbimi Sprovues pas pranimit të dosjes complete dhe vendimit për lirim me kusht nga Paneli për lirim me kusht, fillon mbikëqyrjen e personit të liruar me kusht. Me këtë rast ai takon të miturin, familjarët e tij dhe përgatit programin individual për mbikëqyrjen e tij, me përmbushjen e të cilit program synohet re integrimi dhe risocializimi i personit të liruar me kusht në komunitet. Për këtë qëllim, zyrtari sprovues bashkëpunon me shkollën, QPS dhe organin e Kujdestarisë, QAP, Qendra të punësimit dhe institucione tjera relevante, si dhe me komunitetin në përgjithësi.

Me qëllim të evidentimit të progresit në përmbushjen e detyrimeve që shqipton Paneli i Lirimit me Kusht dhe të ato që dalin nga programi individual i mbikëqyrjes, zyrtari sprovues bënë raporte të rregullta për Panelin e Lirimit me Kusht.

Në raste kur personi i liruar me kusht nuk bashkëpunon me Shërbimin Sprovues, dështon të përmbush detyrimet e shqiptuara, atëherë zyrtari i Shërbimit Sprovues ka për obligim që ta njoftoj Panelin për lirim me kusht me një raport të veçantë me propozim për revokimin e vendimit për lirim me kusht

6. SHËRBIMI KORREKTUES

6.1 Roli:

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) është themeluar më 05 Nëntor 1999 fillimisht me hapjen e Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Në maj të vitit 2000 për herë të parë rekrutohen personel korrektues të rinj.

Shërbimi Korrektues është një shërbim funksional dhe i avancuar në të gjitha fushat. Kjo ka ardhur si rezultat i ndihmës së bashkësisë ndërkombëtare që nga themelimi. SHKK, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet në Kosovë synon të korrektojë dhe ri-socializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. Në këtë kuadër, Roli i SHKK-së është i fokusuar te përgjegjësia për administrimin e të burgosurve, paraburgosurve, dënuarve, miturve në bazë të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, si dhe konventave Evropiane dhe rregulloreve të tjera të lëshuara në institucionet përkatëse. SHKK-ja është përgjegjës për menaxhimin e institucioneve të niveleve të ndryshme të sigurisë dhe mbikëqyrjen e personave nën kujdesin e SHKK-së.

6.2 Dispozitat e shërbimeve:

6.2.1 Ekzekutimi i masës së dorëzimit në institucionin edukativ korrektues

Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektues ekzekutohet në institucionin edukativ korrektues të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektues është institucion korrektues i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Gjykata kompetente e informon institucionin edukativ korrektues për datën kur i mituri duhet të paraqitet dhe i dorëzon vendimin e formës së prerë së bashku me të dhënat personale mbi të miturin të mbledhura gjatë procedurës.

Gjykata kompetente me shkrim urdhëron të miturin të paraqitet në institucionin edukativo-korrektues në një ditë të caktuar për ekzekutimin e masës edukative korrektuese. Periudha kohore nga marrja e urdhrit dhe dita e paraqitjes nuk do të jetë më e shkurtër se tetë (8) ditë dhe as më e gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë. Kur i mituri pranohet në institucionin edukativo-korrektues, së pari konstatohet identiteti i tij, arsyeja e shqiptimit të masës dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, e më pas ai i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda njëzetekatër (24) orëve nga arritja.

Emri i të miturit, arsyet dhe organi që ka shqiptuar masën edukative, data dhe koha për pranimin e tij në institucionin korrektues shënohet në regjistër.

Në qendrën edukativo-korrektuese mund të dërgohen e dhe të miturat vajza por që ato duhet që të vendosen në sektorin e posaçëm të femrave. Përveç ndarjes në meshkuj dhe femra të

miturit që dërgohen në këtë qendër ndahen në grupe edukative në harmoni me moshën e tyre, zhvillimin mendor dhe karakteristikat tjera në pajtim me veçoritë e programit të individualizuar.

Gjatë ekzekutimit të masës edukative të miturit kanë të drejtë që të i ndjekin orët mësimore në kuadër të kësaj qendre dhe në qoftë se për lëndë të caktuar nuk ka orë mësimore ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativo korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim. Në dallim nga personat madhorë i mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, familjarët e afërm dhe të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt. Gjatë qëndrimit në institucionin edukativo-korrektues i mituri ka të drejtë në pushim vjetor prej tridhjetë (30) ditësh të cilat me leje të institucionit korrektues mund të shfrytëzohen edhe jashtë lokaleve të institucionit edukativo-korrektues.

Përveç këtij pushimi, drejtori i institucionit edukativo-korrektues të miturit mund t'i lejojë pushim shtesë nga institucioni edukativo-korrektues për arsye edukative, profesionale, familjare ose arsye të tjera sociale deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë çdo vit.

Gjyqtari për të mitur i cili ka shqiptuar masën edukative ka për obligim që ti viziton të miturit e vendosur në institucion apo qendër një herë në gjashtë muaj, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarët që drejtpërdrejtë janë përfshirë në ekzekutimin e masës edukative institucionale dhe pas shqyrtimit të shënimeve të institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me ligjin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme. Gjyqtari për të mitur menjëherë e informon shërbimin sprovues kompetent dhe institucionin ose qendrën që ekzekuton masën edukative institucionale për çfarëdo të mete apo vërejtje tjetër.

Gjykata kompetente që ka shqiptuar masën edukative shqyrton ekzekutimin e masës edukative çdo gjashtë (6) muaj. I mituri, prindi i tij, prindi adoptues apo kujdestari, qendra, institucioni apo vendi ku ekzekutohet masa edukative ose shërbimi sprovues mund të kërkojnë rishqyrtimin e ekzekutimit të masës edukative. Nëse ekzekutimi i masës edukative nuk ka filluar brenda një (1) viti nga data prej së cilës vendimi mbi shqiptimin e masës bëhet i formës së prerë, gjykata rishqyrton vendimin dhe vendos për ekzekutimin apo pushimin e masës ose zëvendësimin e saj me ndonjë masë tjetër edukative.

6.3 Përgjegjësitë kyçe:

SHKK, në bashkëpunim me të gjithë partnerët e Drejtësisë dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet në Kosovë synon të korrektojë dhe ri-socializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë.

6.3.1 Ekzekutimi i burgut për të mitur

Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për ekzekutimin e dënimit me burgim zbatohen përshtatshëm për ekzekutimin e dënimit me burgim për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me rregullat e KDM-së. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathësitë, interesimet dhe punën që është duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues.

Bazat e trajtimit përfshijnë punën e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësimin dhe inkurajimin e kontakteve mes të miturve dhe botës së jashtme përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe ofrimit të kushteve të nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare. Burgimi për të miturit mbahet në institucion korrektues për të mitur dhe, në raste të jashtëzakonshme, në pavijone të ndara të institucionit korrektues për persona madhorë.

Institucioni korrektues për të mitur është i llojit gjysmë të hapur dhe të hapur. Përrjashtimisht të miturit mund të mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues të tipit të mbyllur.

7. NDËRMJETËSIMI

7.1 Roli

Komisioni për Ndërmjetësim është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmjetësimit i themeluar nga Ministria e Drejtësisë në bazë të nenit 17 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.03/L-057 i datës 18.09.2008. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit burojnë nga Ligji për ndërmjetësim. Veprimtaria e Komisionit bazohet në parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, pavarësisë, profesionalizmit, paanësisë dhe transparencës.

Ndërmjetësimi është mënyrë alternative e zgjidhjes së konfliktit në të cilin pala e tretë që është neutrale dhe e paanshme (ndërmjetësi/ja) ju ndihmon palëve në konflikt për të arritur një marrëveshje të pranueshme nga të gjithë.

Ndërmjetësi është pala e tretë, neutrale e autorizuar të ndërmjetësojë në mes dy palëve me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, në pajtim me parimet e ndërmjetësimit. Parimet e ndërmjetësimit janë: Shprehja e vullnetit, Barazia i palëve në procedurë, Paanshmëria, Fshehtësia dhe Besueshmëria dhe Urgjenca.

Procedura e ndërmjetësimit zhvillohet nga ndërmjetësi është person fizik, i cili i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara me Ligjin për ndërmjetësim dhe është i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësve.

Procesi i ndërmjetësimit përkrah sistemin e Drejtësisë në Kosovë, zvogëlon numrin e rasteve të pazgjidhura, ndikon në thjeshtësimin e procedurës, përsheptimin e saj, uljen e shpenzimeve dhe ndreqjen e raporteve në mes palëve.

7.2. Dispozitat e shërbimit

Në pajtim me dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe Ligjit për Ndërmjetësim, procedura e ndërmjetësimit mund të aplikohet vetëm atëherë kur ekziston vullneti i lirë dhe pjesëmarrja e të dy palëve, kryesit të mitur dhe palës së dëmtuar.

Ndërmjetësimi si mënyrë alternative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tek të miturit mund të propozohet nga prokurori, gjyqtari për të mitur apo kolegji për të mitur nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme duke pas parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe re-integrimi i tij në shoqëri.

Ndërmjetësimin mund të sugjerohet në cilindo fazë të procedurës gjyqësore.

Rastet që mund të procedohen në ndërmjetësim janë:

- rastet në marrëdhëniet kontestuese në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës;
- tregtare;
- familjare;
- të punës;
- raporte të tjera civile;
- administrative; dhe
- penale;

Secili ligj i ka dispozitat e veta si p.sh. te ligji penal rastet të cilat mund të referohen në ndërmjetësim janë ato raste ku parashihet dënimi me burgim deri në 3 vite ose dënimi me gjobë.

7.3 Përgjegjësitë kyçe

7.3.1 Procedura e referimit

Ndërmjetësi lehtëson komunikimin në mes palëve duke krijuar hapësirën e sigurt ku palët mund të shprehin lirshëm ndjenjat, nevojat dhe interesat e tyre. Është shumë me rëndësi që secila nga palët të rrëfejë historinë e vet lidhur me ndodhinë në të kaluarën. Duhet sqaruar çdo gjë që ka sjellë deri te keqkuptimet, fyerjet dhe lëndimet në mënyrë që të riformësohen dhe ndreqen raportet e tyre në të ardhmen.

Ndërmjetësi në mënyrë konstruktive udhëheq seancën e ndërmjetësimit në mes palëve duke u përkujdesur që biseda të rikthehet në binarët e duhur, të shprehen dëshirat dhe nevojat, të kuptohen këndvështrimet e ndryshme dhe perspektivat, përmes të cilave mund të dalin në horizont mundësi të reja zgjidhjeje.

- Para se palët të shkojnë në procedurën e ndërmjetësimit, prokurori ose gjyqtari për të mitur duhet që t'i njoftojë palët për parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, si dhe për procesin dhe efektet ligjore të çdo marrëveshjeje që arrihet përmes ndërmjetësimit, në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim.
- Pasi që palët të pajtohen që rasti i tyre të zgjidhet me ndërmjetësim, prokurori apo gjyqtari për të mitur do ta pezullojë lëndën dhe do të plotësojë urdhrin e prokurorisë apo gjykatës për referim të lëndës në Qendër të Ndërmjetësimit.
- Nëpunësi i prokurorisë apo gjykatës do t'ia dorëzojë menjëherë urdhrin, së bashku me një kopje të padisë Qendrës së Ndërmjetësimit.
- Administratori i Qendrës së Ndërmjetësimit ka për detyrë të kontaktojë me palët dhe ndërmjetësin për t'iu caktuar seancën e parë.
- Pas njoftimit me procesin e ndërmjetësimit, rolet dhe përgjegjësitë e tyre, palët nënshkruajnë marrëveshjen për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit.
- Data në të cilën nënshkruhet marrëveshja për ndërmjetësim do të konsiderohet si datë e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit.

- Nëse ndërmjetësimi nuk kryhet gjatë seancës së parë, do të mbahen seanca të tjera gjersa të kryhet procedura. Qendra e ndërmjetësimit do të rikonfirmojë seancat e tilla me palët dhe ndërmjetësin si dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar se procedura e ndërmjetësimit do të kryhet brenda 90 ditësh.
- Kur palët arrijnë një marrëveshje për ujdinë e kontestit të tyre, ndërmjetësi do të përgatisë marrëveshjen e ujdisë së ndërmjetësuar, që do të nënshkruhet nga i mituri, prindi apo kujdestari i tij, pala e dëmtuar dhe ndërmjetësi. Kjo marrëveshje zyrtarisht i dërgohet prokurorit, gjyqtarit apo kolegjit për të mitur, të cilët me aktvendim mund ta ndërpresin procedurën gjyqësore dhe të njoftojnë palët lidhur me vendimin e tyre.
- Nëse prokurori apo gjyqtari për të mitur miratojnë marrëveshjen e ndërmjetësuar, marrëveshja fiton titull ekzekutiv dhe ekzekutohet na pajtim me ligjin në fuqi.
- Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje për ujdinë e kontestit, ndërmjetësi do të përgatisë raportin mbi mosarritjen e mosmarrëveshjes dhe do t'i raportojë prokurorit apo gjyqtarit.
- Nëpunësi përgjegjës i gjykatës apo prokurorisë do t'ia dorëzojë një kopje të vendimit Qendrës së ndërmjetësimit.
- Gjykatat, Prokuroritë dhe Qendrat e ndërmjetësimit do të ruajnë konfidencialitetin e ndërmjetësimit dhe do t'i vulosin të gjitha dokumentet që i takojnë një procesi të ndërmjetësimit.
- Procedura e ndërmjetësimit për të mitur është pa pagesë për palët. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë edhe pagesën për ndërmjetësin, paguhet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës apo Këshilli Prokurorial i Kosovës.

7.3.2 Përfundimi i Procedurës së Ndërmjetësimit

- Në qoftë se palët bien dakord me mirëkuptim, marrëveshja bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet në katër kopje: dy për palët, një për t'ju dorëzuar gjykatës apo prokurorisë dhe një kopje që mbahet në Qendrën e Ndërmjetësimit.
- Marrëveshja nënshkruhet nga i mituri, prindi apo kujdestari i tij, pala e dëmtuar dhe ndërmjetësi.
- Në rast se brenda 90 ditëve nuk është arritur marrëveshja me ndërmjetësim, rasti rikthehet në prokurori apo gjykatë.
- Procedura e ndërmjetësimit përfundon në rastin kur ndërmjetësi nuk e konsideron të arsyeshme të vazhdohet më tutje apo kur palët deklarohen që dëshirojnë ta ndërpresin procedurën e ndërmjetësimit.
- Ndërmjetësi duhet ta mbajë të fshehtë të gjithë informacionin që mblidhet gjatë procesit të ndërmjetësimit, ose që lidhet me ndërmjetësimin, duke përfshirë edhe faktin që ndërmjetësimi do të bëhet ose është bërë, e duke përjashtuar vetë rastet kur detyrohet nga ligji ose nga politikat publike. Çdo informacion që i është treguar ndërmjetësit në mirëbesim nga njëra nga palë nuk duhet t'u tregohet palëve të tjera pa leje, përveç rasteve kur kjo gjë detyrohet me ligj.

7.3.3 Dosja e ndërmjetësve

Qendra e Ndërmjetësimit dhe nëpunësi përgjegjës i gjykatës kompetente do të mbajnë dokumentet vijuese në dosjen e ndërmjetësimit për secilën lëndë:

- a. Urdhrin e gjykatës për referimin e lëndës te Qendra e Ndërmjetësimit;
- b. Kopjen e dosjes origjinale të lëndës (vetëm padia dhe përgjigja ndaj padisë);
- c. Marrëveshjen e palëve për ndërmjetësim dhe për zgjedhjen e ndërmjetësve;
- d. Marrëveshjen për ujdinë e ndërmjetësuar, ose
- e. Raportin mbi mos arritjen e ujdisë së objektit të mosmarrëveshjes nëse është e zbatueshme; dhe
- f. Vendimin e gjykatës për ujdinë e kontestit përmes ndërmjetësimit/dokumenti ekzekutiv (njoftimi mbi përmbarueshmërinë nga gjykata).

7.3.4 Lista e qendrave të ndërmjetësimit

- Qendra e Ndërmjetësimit në Prishtinë;
- Qendra e Ndërmjetësimit në Gjilan;
- Qendra e Ndërmjetësimit në Ferizaj;
- Qendra e Ndërmjetësimit në Gjakovë; dhe
- Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë.

8. ODA E AVOKATËVE

8.1. Roli:

Avokati luan një rol të rëndësishëm kur çështja mund të pushohet apo mund të mos filloj. Ai duhet të evidentojë të gjitha rastet e mundshme cituar më poshtë dhe të negocioje me prokurorin të gjitha mundësitë për të bërë të mundur që organi i akuzës të mund të çmojë rrethanat në favor të të miturit. Në kushtet kur për një vepër penale dyshimi bie mbi një të mitur, avokati, kur është rasti, duhet të evidentojë faktin se nuk ekzistojnë dyshime të bazuara që i mituri të ketë kryer veprën penale. Avokati duhet të mbajë parasysh gjithashtu se legjislacioni penal bën një dallim në lidhje me kualifikimin e provës dhe të provueshmërisë mes të akuzuarve të mitur dhe atyre të të rriturit, duke parashikuar se për të rriturit kërkohet “dyshimi i arsyeshëm” ndërsa për të miturit “dyshimi i bazuar”. Pavarësisht mungesës së doktrinës kosovare në këtë drejtim, me një interpretim literar duket sikur legjislatori ka dashur të vendosë një standard më të lartë provash për fillimin e procedimit penal për të mitur duke vendosur “dyshimin e bazuar”. Në këtë kuadër dyshimi, për të qenë i bazuar, duhet të bazohet mbi prova, në të kundërt nga “dyshimi i arsyeshëm” i cili mund të mbështetet edhe në indicie duke përfshirë këtu edhe provat e rastësishme apo ato rrethore apo edhe vet dyshimin për shkak të interpretimit të rrethanave. Theksojmë, se ky nivel provueshmërie i ndryshëm shfaqet i tillë vetëm në lidhje me fillimin e procedimit dhe jo të procesit, pasi provueshmëria në procesin penal ka si standard bazë “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Kjo edhe pse nuk është thënë shprehimisht, mund të deduktohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

8.2 Dispozitat e shërbimeve:

8.2.1 Të drejtat e mbrojtësit në lidhje me klientin e tij të pandehur

Ligji ka parashikuar se garantimi i të drejtave vetëm të dyshuarit/të pandehurit nuk është garanci e mjaftueshme për realizimin e të drejtave. Rrjedhimisht të njëjtat të drejta ligji ia ka njohur edhe avokatit mbrojtës. Kjo realizohet duke mundësuar kontakte të lira dhe të fshehta midis avokatit me të pandehurin. Të drejtat e mbrojtësit realizohen duke i garantuar atij njoftimet paraprake në rastin kur duhet të kryhen veprime hetimore (pyetje/kontrolle/këqyrje etj). Një e drejtë tjetër e mbrojtësit është mundësia për të shikuar dhe nxjerr kopje të të gjitha dokumenteve të tjera të lidhura me veprimet hetimore (shkresa, prova, analiza, procesverbale sekuestrimi etj) pas përfundimit të hetimit. Pra çdo dokument që lidhet me gjykimin e çështjes.

Sistemi akuzator garanton barazinë e palëve. Ky parim realizohet duke i dhënë mundësi mbrojtjes jo vetëm të kundërshtojë provat e prokurorit, por edhe të kërkojë atij marrjen e provave në favor të të pandehurit. Avokati duhet të arsyetoj nevojën e provës në lidhje me procedimin konkret. Pra jo çdo kërkesë për marrje prove merret parasysh *a priori*. Vendimi i prokurorit është i ankimueshëm.

8.2.2 Marrja me fëmijë

Marrëdhënia midis avokatit dhe klientit të mitur është thelbësore për një përfaqësim sa më efektiv. Në këtë kuadër, ndodh jo rrallë që praktikantët e ligjit nuk kushtojnë vëmendjen dhe konsideratën e duhur për klientët e tyre të mitur. Ndonjëherë edhe avokatët më të mirë të përgatitur dhe trajnuar e gjejnë veten të fokusuar, vetëm tek “interesi me i lartë” i fëmijës dhe standardet e tij dhe neglizhojnë përjasjen e zakonshme të mbrojtjes ligjore. Ata duhet të mbajnë parasysh se vetëm nëpërmjet këshillimit dhe mbrojtjes efektive, fëmijët ushtrojnë të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, funksioni i avokatit mbrojtës është të bëjë të njohur pozitën, dëshirat dhe mendimin e fëmijës.

8.3 Përgjegjësitë kyce:

8.3.1 Marrja në pyetje nga policia

Avokati mbrojtës duhet të bëjë kundërshtime dhe të përpiqet të shmangë:

- Pyetje të dyfishta dhe të paqarta
- Bërjen e supozimeve përpara pyetjes dhe nuk ka rëndësi nëse supozimi është i vërtetë apo i gabuar, pasi ajo që është e rëndësishme lidhet me faktin se ajo çon drejt një përgjigje të parashikuar.
- Të bëjë pyetje, të cilat përfshijnë fjalë të vështira apo zhargon. Kjo nuk rekomandohet në rastet kur trajtohen çështje të të miturve. I vetmi rast, kur përdorimi i tyre lejohet janë rastet kur i padituri ka të njëjtin koncept për termin sikurse edhe ju.
- Pyetjet udhëheqëse: për shembull: Supozoj se ju e dini kuptimin e fjalës “empati”?
- Ndonëse shumë njerëz mund të përgjigjen “jo”, pyetja në vetvete çon në dhënien e një përgjigje “Po”.
- Të bëjë pyetje që përfshijnë dy negative: për shembull: “A nuk mendon se jo shumë njerëz nuk e dinë kuptimin e fjalës “empati”? Në një rast të tillë është e paqartë se çfarë do të thotë një “Jo” apo një “Po” si përgjigje.
- Pyetje prezumuese: për shembull: "Më thuaj gjithçka di për këta njerëz dhe si të bindën ata të veproje në këtë mënyrë?"

Në këtë rast ai që merr në pyetje përdor terma të padefinuar mirë si p.sh “influcë” dhe “në këtë mënyrë” dhe avokati duhet të bëjë kundërshtime në lidhje me prezumimet e përfshira në këto pyetje.

8.3.2 Rreziqet/Vështirësitë me të rinjtë gjatë procesit të marrjes në pyetje

Avokati mbrojtës duhet të ketë parasysh risqet e mëposhtme kur trajton çështje të të rinjve në konflikt me ligjin:

Të rinjtë janë shpesh të paaftë të pohojnë veten e tyre dhe të kundërshtojnë të rriturit; kjo është arsyeja që ata i përgjigjen pyetjeve ashtu si i kërkojnë të rriturit dhe kjo është e

vlefshme edhe nëse pyetjet bëhet nga avokati mbrojtës. Në çdo rast, avokati duhet ta informojë të riun në lidhje me atë se çfarë ai pret të thotë ky i fundit. I riu i dyshuar duhet të inkurajohet të japë opinionin e tij ndërkohë që ai pyetet nga avokati. Kjo arrihet duke i siguruar të riut se ju, si avokat i tij jeni të interesuar vetëm për atë çka ai mendon dhe se nuk ka përgjigje të drejta apo të gabuara.

Avokati mbrojtës duhet të shmangë çdo formë pyetje që tingëllon si një test për të riun. Kjo bën që i riu të qëndrojë i heshtur ose që ai të japë përgjigjet që priten prej tij. Një tjetër rrezik lidhet me faktin se të rinjtë shpesh tentojnë të përgjigjen “po”, pavarësisht pyetjes dhe asaj çfarë mendojnë. Me qëllim shmangien e këtij problem, është shumë i rëndësishëm formulimi i vetë pyetjes, p.sh “A do ta bësh këtë gjë?” mund të formulohet “Si do ndiheshe nëse do e bëje këtë?”

Krahas sa më sipër, të rinjtë preferojnë shpesh të përgjigjen me “Nuk e di”. Arsyet përse përgjigjen kështu janë:

- sepse ata nuk e kuptojnë pyetjen si një koncept dhe/ose fjalorin e përdorur;
- sepse ata mendojnë se ju prisni që ata të mos e dinë përgjigjen;
- sepse ata nuk dinë shumë në lidhje me pyetjen që i bëhet.

Në këtë kuadër, përgjigja “nuk e di” duhet të vlerësohet me kujdes.

Të rinjtë mund të bëhen shumë shpejt konfuz dhe të shpërqendrohen shumë lehtë. Ata mund ta konsiderojnë atë një humbje kohe dhe si të parëndësishëm e të pavlerë informacionin që i kërkohet. Ju si avokat duhet të siguroni që intervistimi të zhvillohet në një vend qetë dhe i zhveshur nga emocione të forta. Këto kushte e ndihmojnë të riun të përqendrohet.

Ju nuk duhet të pretendoni nga i riu i dyshuar të ketë një përqendrim të vazhdueshëm dhe përgjigje të mira edhe nëse ata janë në kushte optimale. Për këtë arsye është e rëndësishme që procesi i marrjes në pyetje të mos jetë i gjatë. Zgjatja e procesit të marrjes në pyetje e bën të riun konfuz në mënyrë të pavullnetshme dhe ndikon që ai të japë informacion të pasaktë. Ju, si avokat mbrojtës duhet të informoni të gjithë ata që marrin pjesë në procesin e marrjes në pyetje se kohëzgjatja normale e intervistimit është 1 orë deri në 1 orë e ½. Zgjatja përtej kësaj kohe përbën shkelje të të drejtave të të riut.

Të rinjtë tentojnë të interpretojnë pyetjet fjalë për fjalë. Për këtë arsye, ju duhet të shmangni metaforat, analogjitë etj. Pyetja duhet të formulohet në mënyrë që të kuptohet nga i riu.

Prioritetet e të riut janë të ndryshme nga ato të të rriturve. Ata mund të mos e kuptojnë rregullin e një intervistimi, ku intervistuesi bën pyetje dhe i intervistuari përgjigjet. Në rast se i riu përfshihet në pafundësinë e “Pse”, strategjia më e mirë është shpërqendrimi dhe riorientimi i vëmendjes së tyre duke hapur një tjetër temë.

Të rinjtë interpretojnë veprimet e të tjerëve bazuar në karakteristikat dhe termat e tyre emocionalë. Të rinjtë e kanë të vështirë të shohin botën me sytë e të tjerëve dhe për këtë arsye

është e rëndësishme që si intervistuesi ashtu edhe avokati mbrojtës të njohin aspektet zhvillimore të fëmijës. Për shembull: të riut i drejtohet pyetja “Pse të qëlloi shoku?” dhe ai përgjigjet “Sepse ai ishte i mërzhitur”. Në këtë rast është e rëndësishme të verifikohet nëse ai përgjigjet në këtë mënyrë për shkak të afeksionit që ai ka ndaj shokut të tij duke u përpjekur ta justifikojë atë apo sepse ai e di saktësisht sesi reagon zakonisht shoku i tij kur ndodhet në këtë situatë.

Referencat:

Kushtetuta e Kosovës;

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (e adoptuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme Nr. 44/25 të 20 Nëntorit 1989, dhe hyrë në fuqi sipas nenit 49 më 2 shtator 1990);

Kodi i Drejtësisë për të Mitur;

Kodi i Procedurës Penale;

Ligji mbi Shërbimet Sociale;

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta, Gazeta Zyrtare e KSAK-së;

Ligji për Gjykatat;

Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; dhe

Ligji për Ndërmjetësim.

Ky protokoll është publikuar me ndihmën financiare të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë dhe UNICEF zyra në Kosovë. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e IGJK-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqesë pikëpamjet e ZBE dhe UNICEF.

Mbështetje e reformave të drejtësisë për të mitur në Kosovë – Faza 2 mbështetur nga zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga UNICEF.

